



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
KQSHM

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY
DVSM

TESTI I MATURËS

GJIMNAZI I GJUHËVE



Prishtinë, gusht 2008

Emri dhe mbiemri i nxënësit

Shkolla.....

Udhëzime:

Koha: Keni 180 minuta që t' u përgjigjeni 100 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t' i zgjidhni kërkesat.

Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t' u përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t' ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë pa e shkarravitur jashtë, shih shembullin e mëposhtëm.

Numri **1** (një) paraqet numrin e pyetjes në fletën e përgjigjeve

Përgjigja e saktë, në *Fletën e përgjigjeve*, duhet plotësuar në këtë mënyrë me laps të thjeshtë HB



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t' u përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

Lexo me kujdes fragmentin e mëposhtëm dhe përgjigju pyetjeve!

Tregtar flamujsh

I

-Posi... U ba Shqipnija. Dalin të marrët e vikasin: Rrnoftë Shqipnija! Ti i meçëm, përgjegje tue bërtitë në kupë të qiellës: Rrnoftë, po! e shpejt me porositë flamujt. Na shkyeju: rrnoftë! e ti shit, ban pare tue tregtue mbi ndiesit t'ona. Lojë e bukur, por s'të ka dalë...

II

Gaspër Tragaci lëshoi shtizën e u avit kërcnueshëm kah djali. Flamuri ra për tokë. Hilushi s'luejti vendit. Shikonte syt e ftohtë qi lëshojshin shkëndija idhnimi. Tregtari u ndal para tij.

-Mos me kenë hatri i mikses së moçme qi kam me shtëpen t'ande, dij un...

I riu i a priti:

Për hatër t'asaj miksije tash qes bejta me t'u shit flamujt.

Me za qi dridhej prej pezmit, tjetri i a këthei:

-Po, zati ti s'din veç me qitë bejta. Jeta me prralla, bieru mbas andrrave. Më vjen keq për gjind të tuej se tash i qet në rrugë të madhe, më shka shof un. Hajt, hajt qit bejta e dueje Shqipnin: bejttat e Shqipnija kanë me të qitë në dritë...

III

U afrue edhe ma tepër e pëshpëriti si në një fishkullimë:

-U shitne a s'u shitne flamujt, qëndroi a s'qëndroi Shqipnija, un kam mjaft, shyqyr, me jetue: a more vesht? e tash jashtë...

-Kadalë... – i a priti djaloshti me t'eger e syt i vetuen: dal vetë, s'asht nevoja me më qitë jashtë. Por edhe një fjalë due me t'a thanë e të lutem vire në vesh si at këshill qi më dhae par në dugajë. Ti thue se jeton, por rrelesh. Ti je shlye prej numrit të të gjallve qyshse je ndry në kët dugajë mbushë me mall. Ky asht vorri yt. E sa për Shqipni, po të siguroj un se ka me qindrue.

Ernest Koliqi

1. E folmja e narratorit në këtë fragment tregon se ngjarja ndodh më afër:
 - A. Shkodrës
 - B. Tiranës
 - C. Elbasanit
 - D. Prishtinës
2. Fjalja „e tash jashtë!” shpreh:
 - A. dëshirë
 - B. sugjerim
 - C. urdhër
 - D. çudi
3. Narratori në këtë fragment flet në:
 - A. vetën e dytë shumës
 - B. vetën e tretë njëjës
 - C. vetën e dytë njëjës
 - D. vetën e tretë shumës

4. Teksti i narratorit të jashtëm në këtë fragment argumentohet përmes:
- dialogut ndërmjet personazheve
 - gjuhës së narratorit
 - gjuhës së personazheve
 - përshkrimit narrativ
5. Zëri i narratorit në këtë fragment del në fjalinë:
- Dalin të marrët e vikasin: Rrnoftë Shqipnija
 - U afrue edhe ma tepër e pëshpëriti si në një fishkullimë
 - Për hatër t'asaj miksije tash qes bejta me t'u shit flamujt
 - E sa për Shqipni po të siguroj un se ka me qindrue
6. Paragrafi i dytë shquhet për:
- cinizëm
 - simbolikë
 - sarkazëm
 - retorikë
7. Informata themelore e fragmentit përmbledhet në fjalinë:
- Dalin të marrët e vikasin: Rrnoftë Shqipnija!
 - Për hatër t'asaj miksije tash qes bejta me t'u shit flamujt
 - Na shkyeju: rrnoftë! e ti shit, ban pare tue tregtue mbi ndiesit t'ona
 - Po, zati ti s'din veç me qitë bejta. Jeto me pralla, bieru mbas andrrave
8. Personazhi i drejtohet tjetrit: „*Ti thue se jeton po rrehash*”, sepse :
- jeton fshehurazi
 - vrapon pas fitimit
 - vrapon pas iluzioneve
 - jeton me gënjeshtër
9. Lidhëza „*por*”, në fjalinë: „*Por, edhe një fjalë due me t'a thanë e të lutem vire në vesh si atë këshill qi më dhae par në dugajë*”, mund të zëvendësohet me lidhëzën:
- prandaj
 - andaj
 - mirëpo
 - ndërsa
10. Ideja e fjalisë së paragrafit të parë: „*Dalin të marrët e vikasin: Rrnoftë Shqipnija!*” plotësohet me fjalinë:
- Më vjen keq për gjind të tuej se tash i qet në rrugë të madhe, më shka shof un
 - Ti i meçëm, përgjegje tue bërtitë në kupë të qiellës: Rrnoftë, po! e shpejt me porositë flamujt
 - U shitne a s'u shitne flamujt, qëndroi a s'qëndroi Shqipnija, un kam mjaft, shyqyr, me jetue: a more vesht?
 - Gaspër Tragaci lëshoi shtizën e u avit kërcënueshëm kah djali. Flamuri ra për tokë

- 11.** Fjala: „*Me za qi dridhej prej pezmit, tjetri i a këthei*” në shqipen standarde bën:
- Me zë që dridhej nga pezmi, tjetri ia ktheu
 - Me za qi dridhej prej pezmit, tjetri ia këthei
 - Me za që dridhej prej pezmit, tjetri ia këtheu
 - Me zë qi dridhej nga pezmi, tjetri ia këthei
- 12.** Frazja „*vire në vesh*” në paragrafin e tretë do të thotë:
- vare në vesh
 - dëgjoje mirë
 - mbaje mend
 - kuptoje drejt
- 13.** Në fjalinë: „*Shikonte syt e ftoftë qi lëshojshin shkëndija idhnimi*”, figura e paradoksit ndërtohet ndërmjet gjymtyrëve:
- sytë dhe idhnimi
 - ftoftë dhe shkëndija
 - shikonte dhe lëshojshin
 - idhnimi dhe ftoftë
- 14.** Sarkazmi haset në fjalinë:
- Mos me kenë hatri i miksis së moçme qi kam me shtëpin t’ande, dij une...
 - Më vjen keq për gjind të tuej se tash i qet në rrugë të madhe...
 - Po, zati ti s’din veç me qitë bejta. Jeto me pralla, bieru mbas andrrave
 - Posi... U ba Shqipnija. Dalin të marrët e vikasin: Rrnoftë Shqipnija!
- 15.** Personazhet e këtij fragmenti shprehin pikëpamjet e tyre:
- religjioze
 - politike
 - filozofike
 - artistike
- 16.** Optimizmi dhe atdhedashuria shprehen në fjalinë:
- U shitne a s’u shitne flamujt, qëndroi a s’qëndroi Shqipnija , un kam mjaft, shyqyr, me jetue
 - Ti i meçëm, përgjegje tue bërtitë në kupë të qiellës: Rrnoftë, po! e shpejt me porositë flamujt
 - E sa për Shqipni, po të siguroj un se ka me qindrue
 - Bejzat e Shqipnija kanë me të qitë në dritë...
- 17.** Forma „*u avit*” në paragrafin e dytë është folje në diatezën:
- pësore
 - veprore
 - vetvetore
 - mesore
- 18.** Fjala „*vetuen*” në fjalinë: - „*Kadalë... - i a priti djaloshi me t’egër e syt i vetuen*” në shqipen standarde bën:
- vetuan
 - vetmuan
 - vetëtuan
 - vetëtuen

19. Fjala „moçme” për nga etimologjia e saj ka të bëjë me:

- A. moshën
- B. vitet
- C. pleqërinë
- D. afrinë

Lexo me kujdes poezinë e mëposhtme dhe përgjigju pyetjeve!

ME JETUE

Erdhe në jetë
Nuk ka më nevojë për kuje lutje
Kryesorja të jetosh
Këtë gur ta hedhësh më lart se Unë

Prandaj

Sa më pak shikoje veten në pasqyrë
Dhe kurrë mos mendo: i pari
Ai që ka ekzistuar para teje jam unë
Ai që do të kujdeset për ditët e mia të mbrama
Për ëndrrat e mia e qetësinë je Ti
Me pleh kurrë mos u pajto: Nxirre në gjysmë
të natës
në pikë të vapës
asgjë mos rrit, asgjë mos krijo me dhunë
rast i humbur nuk je edhe pse pylli
Dendësohet
Mund ta kalosh natën në Kullën time të vetmuar
Në botë
Dhe si të duash Ti Lumi
Kryesorja: Jetën ta jetosh pa e vrarë
Dhe pa të mbetur në këmbë ndonjë therrë
E saj e zezë
Bashkudhëtari im
Ta provojmë vetveten derisa të kemi frymë.

Ali Podrimja

20. Motivi i kësaj poezie është:

- A. erotik dhe meditativ
- B. patriotik dhe filozofik
- C. social dhe përshkrues
- D. meditativ dhe personal

21. Si formë poezia e dhënë mbështetet në:

- A. varg të rimuar
- B. varg të bardhë
- C. varg të lirë
- D. varg të dyzuar

22. Vargu: „*Nuk ka më nevojë për kuje lutje*” mund të interpretohet si:
- A. besim në jetë
 - B. nxitje për jetën
 - C. zhgënjim nga jeta
 - D. lutje për jetën
23. Përfillja e këshillës së vargut: „*Sa më pak shikoje veten në pasqyrë
Dhe kurrë mos mendo: i pari*”
pengon formimin e një personaliteti:
- A. narcisoid
 - B. injorant
 - C. të ndërgjegjshëm
 - D. të papërgjegjshëm
24. Folja modale haset në vargun:
- A. Ta provojmë vetveten derisa të kemi frymë
 - B. Dhe pa të mbetur në këmbë ndonjë therrë
 - C. Me pleh kurrë mos u pajto, nxirre në gjysmë të natës
 - D. Mund ta kalosh natën në Kullën time të vetmuar
25. Lidhëza „*derisa*” në vargun: „*Ta provojmë vetveten derisa të kemi frymë*”, mund të zëvendësohet me lidhëzën:
- A. mbasi
 - B. teksa
 - C. përderisa
 - D. qëkurse
26. Në vargjet: „*Me pleh kurrë mos u pajto: Nxirre në gjysmë
të natës
në pikë të vapës*”
mbizotërojnë:
- A. rima dhe aliteracioni
 - B. ritmi dhe aliteracioni
 - C. rima dhe asonanca
 - D. ritmi dhe asonanca
27. Poezia e dhënë është:
- A. moderne
 - B. realiste
 - C. surrealistike
 - D. romantike

28. Gradacioni zbritës hetohet në vargjet:

- A. Ai që do të kujdeset për ditët e mia të mbrama je Ti
- B. Asgjë mos rrit, asgjë mos krijo me dhunë
- C. Sa më pak shikoje veten në pasqyrë
- D. Ta provojmë vetveten derisa të kemi frymë

29. Theksi logjik në vargun: „*Nuk ka nevojë më për kuje e lutje*” bie në fjalën apo togfjalëshin:

- A. nuk ka nevojë
- B. për kuje
- C. e lutje
- D. më

30. Folja urdhërore „*mos rrit*” në mënyrën dëshirore, veta e tretë njëjës, diateza joveprore, bën:

- A. mos u rritsh
- B. mos rritsh
- C. mos u rritë
- D. mos rritshin

31. Ndajfolja „*pak*” në shkallën krahasore bën:

- A. më pak
- B. së paku
- C. pakëz
- D. i pakti

Lexo me kujdes paragrafin e mëposhtëm dhe përgjigju pyetjeve!

Problematiciteti shqiptar

Problemi ose Problematiciteti shqiptar... - Kemi trashëguar, thonë, një të shkuar kaotike; po kalojmë, thonë, një të tanishme kaotike: e ardhmja paraqitet si një zero matematike: „*Shiko të shpëtosh kokën tënde!*” - Këtë këngë vajtuese të këndojnë sot Pleq e të Rinj, dogmatikë e liberalë. Të ditur, të paditur, të gjithë njerëzit këtu brenda, i ka zënë një dobësi mistike, një lodhje morale dhe materiale. Dhe, si një rrjedhje e natyrshme e gjithë kësaj gjendjeje, një egoizëm vetjak, materialist, i lidhur ngusht me indiferencën, mërinë, ligësinë, dinakërinë më të përçmuar tejprtej!. – Simptoma më tipike dhe me klasike të dekompozimit. Simptoma të dekadencës, që paraqitin popujt në mbrëmjen e historisë së tyre...
Ku gjendemi?

Branko Merxhani

32. Forma e shkrimit si në fragmentin e dhënë më lart është tipike për:

- A. kritikën
- B. poezinë
- C. prozën
- D. esenë

- 33.** Diskursi i përdorur në këtë fragment është:
- letrar - shkencor
 - eseistik - politik
 - letrar - artistik
 - gazetaresk - politik
- 34.** Në tekstin e dhënë, cilat janë simptomat e „*dekadencës, që paraqitnin popujt në mbremjen e historisë së tyre...*”?
- e shkuara kaotike, e tanishmja kaotike, e ardhmja si zero matematike
 - të gjithë njerëzit, pleq e të rinj, këndojnë të njëjtën këngë vajtuese
 - egoizmi vetjak, materializmi, indiferenca, mëria, ligësia, dinakëria
 - të gjithë njerëzit, si dogmatikët dhe liberalët i ka zënë një dobësi mistike
- 35.** Titulli më i përshtatshëm për këtë tekst do të ishte:
- rrëmuja shqiptare
 - prishja morale
 - politika shqiptare
 - mbrëmja e historisë
- 36.** Sinonimi i fjalës „*egoist*” në shqip është:
- i pacipë
 - i pagdhendur
 - vetjak
 - keqbërës
- 37.** Frazja: „*Shiko të shpëtoç, kokën t'ëndë!*” në kuptim jo të figurshëm bën:
- përpiqu të shpëtosh vetveten
 - shiko të shpëtosh kokën
 - shiko të shpëtosh vetveten
 - përpiqu ta shpëtosh kokën
- 38.** Në strukturë të rregullt, sindetike të periudhës: „*Kemi trashëguar, thonë, një të shkuar kaotike; po kalojmë, thonë, një të tashme kaotike, e ardhmja na paraqitet si një zero matematike*” fitohet:
- periudhë me fjali të varur lejore
 - periudhë me fjali të varur shkakore
 - periudhë me fjali të varur kohore
 - periudhë me fjali të varur vendore
- 39.** Fjala „*më klasike*” në kontekstin e fjalisë së parafundit të tekstit të dhënë është:
- ndajfolje në shkallën pohore
 - ndajfolje në shkallën krahasore
 - mbiemër në shkallën krahasore
 - mbiemër në shkallën pohore
- 40.** Pas Kongresit të Drejtshkrimit, gjuha jostandarde mund të përdoret në:
- shkrime letrare
 - shkresa administrative
 - punime shkencore
 - relacione zyrtare

ENGLISH LANGUAGE

41. Tom owns Jack a large amount of money. Jack says he owns him exactly 11,875 Euros. Tom owns Jack _____.

- A. eleven thousand and eight hundred and seventy-five Euros
- B. eleven thousand and eight hundred seventy-five Euros
- C. eleven thousand, eight hundred and seventy-five Euros
- D. eleven thousand, eight hundred, seventy-five Euros

42. Samantha, John and Ricky are students. They have had six examinations so far. Below is the table with their examination scores taken from students' examination records.

Read the table carefully and choose the correct answer:

| EXAMS | SAMANTHA | JOHN | RICKY |
|------------------------|-------------|-------------|-------------|
| ENGLISH | 10 | 9 | 6 |
| LITERATURE | 7 | 8 | 9 |
| SPANISH | 8 | 8 | 7 |
| ARTS | 9 | 10 | 6 |
| MEDIA & COMMUNICATIONS | 6 | 9 | 10 |
| GENDER STUDIES | 10 | 8 | 9 |
| Average grade | 8.33 | 8.66 | 7.83 |

- A. Ricky is as good as John in literature.
- B. John's got the highest score in arts.
- C. Samantha isn't the best student in English.
- D. Ricky's score in literature isn't the highest.

43. Read this text and then choose a sentence to complete the paragraph:

It was a cold winter evening and we were driving through the forest on an icy road. Suddenly the car stopped and we couldn't go on. We left the car on the road and decided to walk. We soon saw a house in the forest. We knew someone must be in since _____.

- A. we couldn't see anyone around
- B. there were no lights on in it
- C. everything was very quiet and peaceful
- D. the smoke was coming from the chimney

44. Choose the correct answer to complete the question:

I didn't sleep all night long. The wind blew and I felt very _____.

- A. uncomfortable
- B. uncomfortably
- C. much comfortable
- D. non-comfortable

45. Choose a word to complete the following sentence:

I wanted to give a big party at a restaurant in the outskirts of the city. The manager told me that he had to _____ additional staff if I wanted to have a real successful party.

- A. hire
- B. beg
- C. invite
- D. ask

46. The underlined word in the sentence: 'It is my wish that you all come and spend this summer with us.' is _____.

- A. a verb
- B. a noun
- C. an adverb
- D. an adjective

47. Look at the following nouns. One of them DOES NOT exist. Which one?

- A. organization
- B. celebration
- C. **realation**
- D. collation

48. Choose the best way to join the following sentences:

I will grow up.

I will become a successful businessman.

- A. I will become a successful businessman if I grow up.
- B. I will become a successful businessman when I grow up.
- C. I will become a successful businessman and I will grow up.
- D. I will become a successful businessman since I will grow up.

49. Choose the correct sentence:

- A. I had expected to find him at home as usual.
- B. I expected to had find him at home as usual.
- C. I had expected to find him as usual at home.
- D. I expected to had find him as usual at home.

50. Look at the words in the box and choose which sentence below is correct:

presents – could – the – see – not – children – wait – to - their

- A. The presents could not wait to see their children.
- B. The children not could wait to see their presents.
- C. The children could not see to wait their presents.
- D. The children could not wait to see their presents.

51. In this group of words three words have similar meaning except one. Choose one word that is NOT similar to other three.

- A. receive
- B. take
- C. give
- D. accept

52. Choose the correct word to complete the following sentences:

'I love boxing. So does everybody. We always watch the _____ of our favourite boxers.'

'I looked everywhere: on the table, in the drawers, in my bag... I couldn't find them. So I went to the supermarket and bought some _____.'

- A. games
- B. matches
- C. rounds
- D. gloves

53. You go into a shop and you are not sure whether you want to buy something or not.

If the shop assistant asks you, 'Can I help you?' from the following expressions:

- 1. I'm just browsing.
- 2. I'm just surfing.
- 3. I'm just viewing.
- 4. I'm just shop-lifting.

you should say '**I'm just browsing**' because _____.

- A. you are just looking
- B. you are just checking
- C. you are just observing
- D. you are just bargaining

54. The word float does NOT rhyme with only one of these words. Which one?

- A. antidote
- B. toast
- C. taught
- D. remote

55. In the string of words: badly, lovely, smoothly, roughly, brilliantly, the word lovely is different because _____.

- A. it is an adverb
- B. it ends in 'ly'
- C. it begins in 'l'
- D. it is an adjective

56. The sentence 'Did you see Claire yesterday evening?' is in the _____.

- A. past simple tense
- B. present perfect tense
- C. future simple tense
- D. past continuous tense

57. Read the paragraph carefully:

The big challenge facing scientists trying to rid mankind of the misery of common flu is finding a drug that can combat the huge and ever-changing variety of cold viruses. Researchers are looking for features that all such viruses share. **Whichever drug company comes up with something is guaranteed to make a fortune.**

Look at the highlighted text and complete the following sentence:

The author _____.

- A. supposes the company will make a lot of money
- B. thinks that the company will make a lot of money
- C. hopes that the company will make a lot of money
- D. is positive that the company will make a lot of money

58. Read the following sentences carefully:

1. I believe this is what life-long learning is about.
2. However, he always said he learnt a lot from us, the youngsters.
3. Always calm and understanding, he served as a mentor to many of us.
4. My grandfather was a really remarkable person.
5. We never made big decisions without having turned to him.

The correct order of sentences to form a paragraph is _____.

- A. 1 4 5 3 2
- B. 4 3 5 2 1
- C. 4 5 3 1 2
- D. 5 4 2 1 3

59. When you see the sign: 'Beware of dogs!' you know that _____.

- A. dogs are wanted there
- B. dogs are allowed there
- C. you should be careful
- D. you should be happy


60. There are only two countries in the world in which drivers drive on the left side of the road. One of these countries is Japan, whereas the other is _____.

- A. Great Britain
- B. Portugal
- C. South Africa
- D. Gambia

MATEMATIKË

61. Është dhënë figura. Cila nga shprehjet vijuese paraqet syprinën e pjesës së hijezuar të figurës?

- A. $af - \frac{1}{2}ab$
- B. $ab + \frac{1}{2}ac$
- C. $\frac{1}{2}(af + ab)$
- D. $\frac{1}{2}(af - ab)$



62. Një trup është hedhur nga lartësia prej 250 m. Gjatë sekondës së parë ai zbrit për 15 m, gjatë sekondës së dytë 25 m, gjatë sekondës së tretë 35 m e kështu me radhë. Kur do të bjerë trupi në tokë?


- A. për më pak se 6 sek.
- B. ndërmjet sekondës 6 dhe 7
- C. ndërmjet sekondës 7 dhe 8
- D. pas sekondës së 8

63. Cila është pikë e përbashkët e funksioneve $y = x^2 - x$ dhe $y = 1 - x$?

- A. (0, 0)
- B. (0, 1)
- C. (1, 0)
- D. (1, 1)

64. Është katërkëndëshi ABCD. Cili ekuacion kuadratik përcakton vlerën e x -it sipas të dhënave në figurë ?

- A. $x^2 + 16x = 0$
- B. $x^2 - 16x = 0$
- C. $x^2 - 20x + 16 = 0$
- D. $x^2 + 20x + 16 = 0$



65. Në qoftë se vlen: $a^2 - b^2 = 117$ dhe $a + b = 3$, atëherë sa është vlera e shprehjes $a - b$?

- A. 31
- B. 33
- C. 36
- D. 39

66. Sa është vlera e shprehjes numerike komplekse: $A = (\sqrt{1-i})^4$, ku $i^2 = -1$?

- A. $A = -2i$
- B. $A = 1 - 2i$
- C. $A = 1$
- D. $A = -i$

67. Në një bufë ndodhen 50 mysafirë, prej të cilëve 32 pinë kafe, 24 pinë ujë, kurse 12 pinë edhe kafe edhe ujë. Sa prej tyre nuk pinë as kafe e as ujë ?

- A. 0
- B. 1
- C. 6
- D. 8


68. Në një kompani janë tri grupe punëtorësh që marrin të ardhura sipas kualifikimeve, siç është paraqitur në tabelë. Sa janë, përafërsisht, të ardhurat mesatare ?

- A. 260 €
- B. 262.85 €
- C. 263.95 €
- D. 263 €

| Grupi | Numri i punëtorëve | Të ardhurat |
|-------|--------------------|-------------|
| I | 20 | 240€ |
| II | 10 | 280 € |
| II | 5 | 320€ |

69. Është dhënë katrori ABCD (shih figurën) i cili rrotullohet për 450° me qendrën e rrotullimit në pikën e prerjes së diagonaleve të tij. Cili përkëmbim i përgjigjet këtij rrotullimi ?

- A. $f \begin{pmatrix} A & B & C & D \\ B & C & D & A \end{pmatrix}$
 B. $f \begin{pmatrix} A & B & C & D \\ C & D & A & B \end{pmatrix}$
 C. $f \begin{pmatrix} A & B & C & D \\ D & A & B & C \end{pmatrix}$
 D. $f \begin{pmatrix} A & B & C & D \\ A & B & C & D \end{pmatrix}$



70. Cila shprehje numerike i përgjigjet fjalisë:

“ Prodhimi i shumës së numrave 0.6 dhe 0.4 me diferencën e tyre i rritur për 0.64 “ ?

- A. 0.82
 B. 0.84
 C. 1.12
 D. 1.14

HISTORI

71. Periudha historike nga shekulli X-XV karakterizohet me rendin shoqëror:

- A. Skllavopronar
 B. Feudal
 C. Kapitalist
 D. Socialist

72. Beteja e dytë e Kosovës e vitit 1448 u zhvillua në mes të:

- A. Mbretërisë Serbe dhe Perandorisë Osmane
 B. Perandorisë Bizantine dhe Perandorisë Osmane
 C. Koalicionit Ballkanik dhe Perandorisë Osmane
 D. Mbretërisë Hungareze dhe Perandorisë Osmane

73. Sllavët e vjetër jetonin në hapësirën ndërmjet lumit Dnjepër dhe maleve Karpate.

Cilat ishin shkaqet e dyndjeve të popullsisë sllave nga këto hapësira?

- A. Shtimi i popullsisë, kushtet e papërshtatshme klimatike dhe sulmet e hunëve
 B. Shtimi i popullsisë, kushtet e papërshtatshme klimatike dhe sulmet e Bizantit
 C. Sulmet e osmanëve dhe mungesa e popullsisë vendëse
 D. Sulmet e romakëve dhe shtimi i popullsisë vendëse

74. Radhitni sipas rendit kronologjik, ngjarjet të cilat shënuan procesin e shturjes së Perandorisë Osmane dhe zgjerimin e shteteve sllave në Ballkan:

- A. Kongresi i Berlinit, Konferenca e Shën Stefanit dhe Luftërat Ballkanike
 B. Luftërat Ballkanike, Kongresi i Berlinit dhe Konferenca e Shën Stefanit
 C. Konferenca e Shën Stefanit, Kongresi i Berlinit dhe Luftërat Ballkanike
 D. Luftërat Ballkanike, Konferenca e Shën Stefani dhe Kongresi i Berlinit

- 75.** Cilat ishin dallimet në jetën politike të Gjermanisë dhe të Italisë pas Kongresit të Vjenës ?
- A. Gjermania ishte politikisht e copëtuar, por me një Prusi të fortë, ndërsa Italia e copëtuar dhe pjesërisht e pushtuar
 - B. Gjermania ishte politikisht e copëtuar, por me një Prusi të dobët, ndërsa Italia e copëtuar dhe pjesërisht e pushtuar
 - C. Italia ishte e copëtuar dhe pjesërisht e pushtuar, ndërsa Gjermania politikisht e bashkuar
 - D. Italia ishte politikisht e bashkuar, ndërsa Gjermania e copëtuar dhe pjesërisht e pushtuar

- 76.** Skolastika mesjetare në raport me idetë Iluministe paraqiste :
- A. injorancën dhe rëndësinë e aktiviteteve shoqërore, si mënyrë për të siguruar përjetësinë në Parajsë
 - B. injorancën dhe mos rëndësinë e aktiviteteve shoqërore, në krahasim me dobitë nga jeta në Parajsë
 - C. një hap para në të menduarit shoqëror, që përparimin e njeriut e shihte në forcimin e dogmave fetare
 - D. një hap mbrapa në të menduarit shoqëror, që përparimin e njeriut e shihte në forcimin e pushtetit mbretëror

- 77.** Hapësira e paraqitur në hartë me vija horizontale shënon zonën e okupuar të Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore nga forcat:

- A. Italiane
- B. Bullgare
- C. Serbe
- D. Gjermane



- 78.** Cili është roli i Konferencës për Sigurim dhe Bashkëpunim Evropian ?
- A. Ndërtimi i marrëdhënieve kulturore
 - B. Forcimi i marrëdhënieve ekonomike
 - C. Forcimi i marrëdhënieve ndërshtetërore evropiane
 - D. Ndarja në mes shteteve të zhvilluara dhe të pazhvilluara evropiane

GJEOGRAFI

79. Cili liqe natyral në trojet etnike i takon tri shteteve?

- A. Liqeni i Ohrit
- B. Liqeni i Shkodrës
- C. Liqeni i Butrintit
- D. Liqeni i Prespës

80. Janë dhënë pohimet:


- I. Drini është lumë me prurjen më të madhe të ujit në trojet etnike
- II. Drini është lumë me gjatësinë më të madhe në trojet etnike
- III. Drini është lumë me shpejtësinë më të madhe të ujit në trojet etnike

Cili nga pohimet është i saktë?

- A. Vetëm I
- B. Vetëm II
- C. Vetëm III
- D. I, II dhe III

81. Cili është kryeqyteti i shtetit të hijezuar në hartë ?

- A. Pekini
- B. Riadi
- C. Teherani
- D. Bagdadi



82. Cilat brigje të kontinenteve lagen nga Deti i Karaibeve?

- A. Brigjet e Evropës dhe të Afrikës
- B. Brigjet e Amerikës Veriore dhe të Evropës
- C. Brigjet e Amerikës Jugore dhe të Evropës
- D. Brigjet e Amerikës Veriore dhe të Amerikës Jugore

83. Si quhen pronat e mëdha bujqësore në të cilat zakonisht kultivohet një kulturë?

- A. Plantazhe
- B. Prerie
- C. Stepe
- D. Savane

84. Ndërrimi i drejtimit të lëvizjes së erërave pasate jugore është pasojë e:

- A. shpejtësisë së rrotullimit të Tokës rreth Diellit
- B. shpejtësisë së njëjtë të të gjitha gjerësive gjeografike rreth boshtit të Tokës
- C. shpejtësisë jo të njëjtë të të gjitha gjerësive gjeografike rreth boshtit të Tokës
- D. shpejtësisë jo të njëjtë të lëvizjes së masave ujore

85. Cili nga pohimet është i saktë ?

- A. Transgresioni është dukuri që karakterizohet me përmbytjen e pjesëve të kontinenteve nga uji i detit
- B. Transgresioni është dukuri që karakterizohet me tërheqjen e ujit të detit nga pjesët e kontinenteve
- C. Transgresioni është dukuri që karakterizohet me ngritjen e brigjeve të detit
- D. Transgresioni është dukuri që karakterizohet me çarjen e tokave në brigjet detare

FILOZOFI

86. Nëse një qytetar nuk e respekton kontratën shoqërore dhe vullnetin e përgjithshëm, çfarë duhet të bëjë sovrani sipas Rusoit në këtë rast?

- A. Duhet ta detyrojë qytetarin të veprojë në përputhje me kontratën shoqërore
- B. Duhet ta lërë qytetarin të veprojë ashtu si e ndien qytetari sipas ndërgjegjes së tij
- C. Duhet ta detyrojë në burg dhe t'ia marrë lirinë
- D. Assesi nuk duhet ta detyrojë qytetarin të jetë i lirë

87. Cili nga këto njësi sintaksore paraqet gjykimin në logjikë:

- A. “Të na jetojë Sokrati!”
- B. “Sokrati është i vdekshëm”
- C. “Qoftë i nderuar Platoni!”
- D. “A është Aristoteli babai i logjikës?”

88. Hipotezë quajmë:

- A. supozimin absolutisht të sigurt, por që nuk ka gjasë të vërtetohet mbi ndonjë dukuri apo grup dukurish
- B. pohimin dogmatik për ndonjë dukuri natyrore, por jo edhe për dukuri shpirtërore e psikike
- C. dogmën fillestare dhe të sigurt mbi të drejtat dhe liritë e njeriut si qenie racionale që ka një vullnet të lirë dhe një ndërgjegje, e cila supozohet të jetë diçka shpirtërore dhe e pavarur nga trupi
- D. supozimin fillestar dhe jo të sigurt, por që ka gjasë të vërtetohet, supozim ky në bazë të cilit mund të jepen shpjegimet e para lidhur me ndonjë dukuri apo grup dukurish

89. Sipas metafizikës së Aristotelit “substanca e parë” ka kuptimin e:

- A. qenies së drejtpërdrejtë individuale, e cila nuk mund të jetë predikat, por prapë dhe vetëm e vetëm subjekt
- B. qenies së drejtpërdrejtë individuale, e cila mund të jetë predikat
- C. substancave kimike-biologjike të zbërthyeshme nga kategoritë
- D. përcaktueshmërisë së përgjithshme të qenies individuale që gjendet në botë si i dërguar pa vullnetin e tij

90. Çfarë do t'i kishin rekomanduar hedonistët një njeriu që mundohet të jetojë në mënyrë asketike:

- A. I rekomandojnë të shikojë mesin e artë në çdo aspekt të moralit
- B. I rekomandojnë që të vazhdojë jetën e tij të thjeshtë dhe pa kënaqësi
- C. I rekomandojnë të jepet pas jetës ndijore e trupore dhe me plot kënaqësi
- D. I rekomandojnë që të jetojë në harmoni me natyrën dhe qytetërimin ku jeton

PSIKOLOGJI

91. Cili drejtimi psikologjik sqaron fenomenet psikologjike si të përbëra nga “elementet” e veçanta ?

- A. Drejtimi Psikoanalitik
- B. Drejtimi Biheviorist
- C. Drejtimi Kognitiv
- D. Drejtimi Strukturalist

92. Çfarë kanë të përbashkët amnezia dhe hiperamnezia?

- A. Janë procese normale të kujtesës
- B. Janë funksione të të menduarit
- C. Janë çrregullime të kujtesës
- D. Janë forma të të mësuarit

93. Çrregullimi i ankthit, që karakterizohet me frikë të vazhdueshme dhe irracionale të individit nga një objekt specifik, aktivitet apo situatë që krijon një dëshirë detyruese për t’iu shmangur asaj, është:

- A. Çrregullimi bipolar
- B. Çrregullimi fobik
- C. Çrregullimi obsesivo-kompulsiv
- D. Çrregullimi i shumëfishtë i personalitetit

94. Afektet janë:

- A. Emocione të vullshme dhe intensive, të cilat nuk zgjasin shumë
- B. Emocione të vullshme dhe intensive, të cilat zgjasin relativisht shumë
- C. Gjendje emocionale, të cilat zgjasin relativisht shumë dhe janë intensive
- D. Gjendje emocionale të cilat zgjasin relativisht shumë, por nuk janë intensive

95. Në periudhën e fëmijërisë së mesme (mosha 7 deri në 11 vjet) fëmijët sipas Zhan Piazhësë ndodhen në fazën operacionale konkrete të zhvillimit kognitiv.

- I. Në këtë stad fëmija është egocentrik, që do të thotë fëmija është i paaftë për t’i kuptuar gjërat nga pikëpamja e tjerëve
- II. Në këtë stad fëmija përvetëson konceptin e konservimit, që do të thotë kupton se karakteristikat e objekteve mbeten të njëjta, përderisa nuk shtohet apo nuk hiqet gjë
- III. Në këtë stad fëmija ka aftësi për të përdorur koncepte abstrakte

Cili nga pohimet është i saktë ?

- A. Vetëm I
- B. Vetëm II
- C. Vetëm III
- D. I, II dhe III

SOCIOLOGJI

96. Themelues i “filozofisë pozitive” është:

- A. Ogyst Konti
- B. Emil Dyrkemi
- C. Karl Marksi
- D. Maks Veberi

97. Çfarë kanë të përbashkët monarkia dhe demokracia?

- A. Janë faktorë të socializimit
- B. Janë forma të asimilimit të popullatës
- C. Janë forma të qeverisjes
- D. Janë përbërës të kulturës

98. Poliandria është:

- A. Martesa e një individi me një partnerë
- B. Martesa e një individi me më shumë partnerë
- C. Martesa e një burri me dy apo më shumë gra
- D. Martesa e një gruaje me dy apo më shumë burra

99. Sipas Veberit stratifikimi shoqëror është tredimensional; ekonomik, politik dhe kulturor. Dimensionit Ekonomik të stratifikimit i referohet si Klasë dhe nënkupton:

- A. Dallimin e grupeve shoqërore sipas prestigjit dhe stilit të jetës
- B. Dallimin e grupeve shoqërore sipas kriterit të fuqisë apo pushtetit
- C. Dallimin e grupeve shoqërore sipas prestigjit dhe pozitës në tregun e punës
- D. Dallimin e grupeve shoqërore sipas kriterit të pronës dhe pozitës në tregun e punës

100. Janë dhënë pohimet

- I. Relativizimi kulturor është vlerësimi i kulturës përmes standardit kulturor që ka vetë individi
- II. Relativizimi kulturor ka të bëjë me theksimin e dallimeve kulturore ndërmjet grupeve të ndryshme
- III. Relativizimi kulturor thekson se gjitha kulturat janë të lidhura mes veti dhe janë të vlefshme

Cili nga pohimet është e saktë?

- A. Vetëm I
- B. Vetëm II
- C. Vetëm III
- D. I, II dhe III